REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2019:125978
Datë: 31.05.2021
Numri i dokumentit: 01833587

C.nr. 141/18.

GJYKATA THEMELORE NE PEJË - DEGA NE ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm -Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Migjen Kastrati, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit I. G. nga fshati ....., Komuna e ....., të cilin e përfaqëson K. H. - F. avokate nga Istogu, sipas autorizimit, kundër të padituës Komuna e Istogut - Drejtoria e Arsimit Istog, përfaqësuar nga avokati Publik Komunal A. A., nga baza juridike: kompensim i pagave përcjellëse në pension dhe shpërblim jubilar, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor nën prezencën e të autorizuarës të paditësit, e në mungesë të përfaqësuesit të te padituës me datë, 18.05.2021, mori ndersa me datën, 31.05.2021 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit, I. G. , nga fshati ....., Komuna e .....

II. DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, që paditësit, I. G. , nga ..... fshati ....., Komuna e ....., në emër të kompensimit të shpërblimit për 3 (tri) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, në shumë prej: 1,359.66 euro, dhe në emër 2(dy) pagave të shpërblimit jubilar, sipas listës së pagave, në shumë prej: 622.56 euro, dhe atë në shumë të përgjithshme prej: **2,428.41 euro,** me kamatë ligjore prej, 8 %, e cila llogaritet nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë me datë, 02.05.2018, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit ligjorë.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, që paditësit t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej: 569,00 Euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit ligjorë.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarës të tij në padi si dhe me precizimin e kërkesëpadisë, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që të: APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit, I. G. , nga fshati ....., Komuna e ..... DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, që paditësit, I. G. , nga ..... fshati ....., Komuna e ....., në emër të kompensimit të shpërblimit për 3 (tri) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, në shumë prej: 1,359.66 euro, dhe në emër 2(dy) pagave të shpërblimit jubilar, sipas listës së pagave, në shumë prej: 622.56 euro, dhe atë në shumë të përgjithshme prej: 2,428.41 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga data e marrjes së këtij aktgjykimi me datën: 18.05.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjorë DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, që paditësit t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej: 569,00 Euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

2019:125979

E autorizuara e paditësit gjatë seancës së shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbete në tërësi pranë padisë përkatësisht pranë precizimit të kërkesëpadisë, pranë deklarimeve nga seancat paraprake përkatësisht në deklarimin e seancës se dt. 19.04.2021. duke shtuar se për palën paditëse me provat e bashkangjitura padisë dhe dorëzuar në këtë gjykatë në tërësi është vërtetuar baza juridikë e kërkesëpadisë e cila gjënë mbështetje edhe në Kontratën Kolektive e miratuar për zbatim në terë territorin e Republikës se Kosovës, saktësisht me nenin 35 pika 8 të kësaj kontrate. Të gjithë të punësuarve në Kosovë pas pensionimit iu takon e drejta për shpërblim jubilar dhe për përcjellje në pension. Ndërsa sa i përket lartësisë se kërkesëpadisë e njëjta është vërtetuar përmes ekspertizës financiare që është nxjerr në këtë gjykatë, përmes eksperti financiar U. S. e dorëzuar në gjykate me dt. 26.02.2021. Pala paditëse ka bëre precizin e kërkesëpadisë për nga lartësia e saj duke u mbështetur në ekspertizën financiare në seancën e dt. 19.04.2021, propozim tjera nuk kemi. Gjykatës i propozojmë që të lejoj precizim e kërkesëpadisë dhe të bëjë administrimin e provave materiale në shkresat e lëndës dhe s'jemi të gatshëm për dhënien e fjalës përfundimtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar- specifikuar dhe atë, 104.00 €, për përpilimin e padisë, taksë gjyqësore, 20.00 €, për një seancë te mbajtur shumen prej 135.00 €, për një seancë të shtyrë shumën prej, 75 euro, për një seancë shumën prej 135.00 euro, sipas Tarifës se Odës se Avokateve të Kosovës, dhe 100 euro për shpenzimet për ekspertizën Financiare ekspertit U. S. , e në shumën e përgjithshme prej 569.00 Euro.

Seanca e shqyrtimit kryesor është mbajtur në mungesë të paditurës konform dispozitës së nenit 423.4 të LPK- së, e cila ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Në përgjigje në padi e dorëzuar me shkrim me datën, 14.06.2019, e paditura e ka kontestuar kërkesëpadinë duke konsideruar se padia është e pa rregullte kurse kërkesëpadia e pa bazë dhe për këtë edhe ka propozuar që e njëjta të hedhet si e pa rregullte, ose kërkesëpadia të refuzohet si e pa bazë**,** si për nga baza ashtu edhe nga lartësia, se padia është e pa rregullte kurse kërkesëpadia të refuzohet si e pa bazë, me tutej ne përgjigje në padi ka theksuar se, kërkesëpadia-petitumi është i pa qartë për ketë as që ekziston, mundësia që pala e paditur të deklarohet ne lidhej me kërkesëpadinë e paditësit, se padia është e pa rregullte për faktin se paditësi nuk ka vepruar në harmoni me neni 25 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit. Duke potencuar pretendime te tjera ne ketë përgjigje në padi me shkrim, për çka është propozuar qe e njëjta të hedhet si e pa rregullte ose të refuzohet si e pa bazuar.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike gjykata ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova, fotokopje e letërnjoftimit për paditësin, kërkesa për Drejtorin e Arsimit parashtruesi i kërkesës, I. G. , kontrata me nr. 05 nr.1153/13,e datës 11.10.2013, vërtetimi me nr. 05 Nr. 79/17 i datës 17.03.2017 nga komuna e ..... DKA-së, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU '.....", ...Nr. 798/17, dt.15.03.2017, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU '.....'', në Istog, nr. 49, i dt. 14.03.2016, lajmërimi për përfundimin e shërbimit-pensionimit lëshuar nga Komuna e .....- drejtoria e arsimit dhe kulturës, nr. 54/17, me datën 28.02.2017, njoftimi i lëshuar nga SHMU ''.....'', nr. 794/17, ...me datën 28.02.2017, lista e pagave lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës, për periudhën 01.12.2016 - 01.01.2017 - 01.02.2017 - 01.03.2017, ekspertiza financiare e punuar nga eksperti U. S., e datën, 26.02.2021, kërkesa e datës, 22.05.2017 e dorëzuar në DKA, me nr. protokolli 05.016, shtojcë 22532, njoftimi i lëshuar nga komuna e ..... – DKA-ja, me nr.05 nr. 205/17, i datës 26.05.2017, vërtetimi i lëshuar nga DKA-ja, me nr. 05 nr.846/19 i datës 01.11.2019, foto kopje e letërnjoftimit për paditësi, si dhe deklarimet e të autorizuarës se paditësi.

2019:125979

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga kontrata e punës me nr. 05 nr.1153/13, dt.11.10.2013, vërtetohet fakti se paditësi me date 02.09.2013, kishte lidhur kontratë pune me të padituren këtu Komunën e Istogut - Drejtorati i Arsimit, ku ka qene i punësuar si mësimdhënës në Shkollën ‘’.....’’.

Nga lajmërimi për përfundimin e shërbimit të pensionimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore nr. 05 nr. 54/17 datës, 28.02.2017, vërtetohet fakti se paditësit i ndërprehet marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore në vendin e punës mësimdhënës në SHFMU “.....”-....., me dt. 15.03.2017, për shkak të mbushjes se moshës mandatorë të pensionimit që është gjashtëdhjetë e pese (65) vjeç.

Nga vertetimi i lëshuar nga SHFMU “..... “ në ..... me nr. 798/17 i datës, 15.03.2017, vertetohet se paditësi ka qenë i punësuar në SHFMU “..... “ në ....., e nga përvoja e përgjithshme të punës me gjithësej stazh pune prej 21 vite, 6 muaj, 14 ditë.

Nga vertetimi i lëshuar nga SHFMU ‘.....’’, në ....., me nr. 49, i datës 14.03.2016, është vertetuar se paditësi ka qën mesimdhenës pune pranë kësaj shkolle nga dt. 12.02.1973 e deri dt. 18.07.1981.

Nga vertetimet e lëshuara me numër Nr.798/17, i datës, 15.03.2017, dhe Nr.49, i datës 14.03.2016, gjykata e ka vërtetuar rrethane se paditësi gjithsej përvoj të punës ka 26 vite 11 muaj përvoje punë.

Nga vertetimi i është shruar nga Komuna e .....- DKA, e lëshuara me numër Nr.79/17 e datës 17.03.2017, gjykata e ka vërtetuar rrethane se paditësi, prej dt.01.09.1995 deri 31.08.199 ka 4 vite te plota në Shkollën ....., ...

Nga kërkesa e paditësit drejtuar Drejtorisë së Arsimit ne Istog me datën, 22.05.2017, vërtetohet së i njëjti ti jetë drejtuar me kërkesë për kompensim të tre pagave përcjellës dhe tre jubilare.

Nga njoftimi i Drejtorisë për Arsim në Istog me nr. 05.Nr.205/17, i dt. 26.05.2017 vërtetohet se e paditura i ka kthyer përgjigje paditësit sa i përket kërkesës për kompensim.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë gjykata e ka vërtetuar të njëjtën mbi bazën e listës së pagave. Por sipas propozimi të palës paditëse është bërë edhe nxjerrja e provës me ekspertizë financiare.

Me leximin e ekspertizës financiare të punuar nga eksperti U. S. , e datës 22.02.2021, e dorëzuar në gjykatë me datën, 26.02.2021, është vërtetuar se lartësia e kërkesëpadisë se paditësit I. G. , pas vërtetimit të te dhënave nga dokumentacioni i gjendur në shkresat e lëndës konstatimit përfundimtar me ekspertizë, jepet si me poshtë, në emër të shpërblimit për dy Paga jubilare paditësit i takon shuma prej, 622.56 euro, në emër të shpërblimit për tri paga jubilarë i takon shuma prej 1,359.66 euro, ne total shuma për kompensim është (622.56+1,359.66) 1,982.22 euro, kamata e llogaritur ne shume prej: 1,982.22 euro, është vlera prej: 446.19 euro, totali i shumës për pagesë bashkë me kamatë është (1,982.22+446.19), 2,428.41 euro.

Gjykata gjenë së baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit gjenë në mbështetje në dispozitat ligjore si në vijim:

Në nenin 4, par.2 të Ligjit të Punës (Nr.03/L-212) i cili ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditësit, gjithashtu edhe tani është në fuqi, parashihet se “*Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e*

2019:125979

*përcaktuara me këtë ligj**”.*** Ndërsa në nenin 67 të këtij ligji parashihet se *“1.Kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet: 1.4.* ***kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeq”.*** Po ashtu në nenin 90 të këtij ligji parashihet se *“1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit,2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes.3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”.*

*Gjithashtu, në nenin **36, paragrafi 9,** te Kontratës Kolektive te Arsimit para Universitar te lidhur ne mes të Ministrisë se Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës se Bashkuar te Arsimit shkencës dhe Kulturës se Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015, parashihet : “ Punëtorët (Anëtarët e SBASHK-ut) qe dalin ne pension përfitojnë shpërblimin jubilar ne vlere. Nen paragrafin **9. 1** i cili parasheh “për 10 vjet te përvojës se punës tek punëdhënësi i fundit ne vlere te një page baze; nen paragrafi **9.2** i cili parasheh “ për 20 vjet te përvojës se punës tek punëdhënësi i fundit ne vlere te dy pagave baze; nen paragrafi **9.3** i cili parasheh “ për 30 vjet te përvojës se punës tek punëdhënësi i fundit ne vlere te tri pagave baze; nen paragrafi **9.4** i cili parasheh ” Punëdhënësi i fundit është ai qe paguan shpërblimin jubilar; dhe nene paragrafi **9.5** i cili parasheh “Shpërblimin jubilar paguhet ne afat prej një muaji pas plotësimit te kushteve”. Gjithashtu edhe neni 10 i kësaj kontrate parasheh se “Punëtorët (anëtaret e SBASHK-ut) qe dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse ne lartësi të tri pagave sipas mesatares se tri pagave të fundit të punëtorit. Si dhe duke iu referuar edhe Ligjit për Arsim Komunal, nr.03/L-068, respektivisht nenin 4, shprehimisht citon se ,,Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me arsimin publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, nëse mbështetemi në këtë Ligj dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nenin 16 dhe 17 par.1 pika h), atëherë ky obligim bie ndaj te paditurës Komuna e .....*”, për kompensimi e paditësit.

Në mes palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese se paditësi tek e paditura kanë qenë në marrëdhënie pune, i caktuar në vendin e punës - mësimdhënës në SHFMU “ .....’’, në ....., si mesimdhenës i Gjuhës Shqipe. Zajmi.

Me vendimin e Drejtorisë së Arsimit në Istog, të datës, 28.02.2017 të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës (sipas fuqisë së ligjit), për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare (pensionimit), si datë e përfundimit të shërbimit është data, 15.03.2017.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet si e bazuar. Kjo ngase në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, kur të njëjtit me vendim të të paditurës ju është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionit. Pasi që paditësi në procedurë administrative nga e paditura nuk ju është dhënë kompensimi i pagave përcjellëse dhe pagave jubilare me rastin e shkuarjes në pension, andaj i njëjti ka kërkuar realizimin kompensimit të pagave përcjellëse dhe jubilare në procedurë gjyqësore, çka një e drejtë e tillë ishte e argumentuar dhe e bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të nënshkruar nga MASHT-i, dhe SBASHK-u, me datë, 11.04.2014, e cila ka hyrë në fuqi me datë, 01.01.2015, andaj gjykata e detyroi të paditurën, që paditësit t'ia paguajë pagat në emër të shpërblimit jubilar sipas përvojës së punës që ka arritur deri në momentin e pensionimit, si

2019:125979

dhe pagat për përcjellje në pension, në lartësi të tri pagave të fundit të cilat i kanë realizuar këtu paditësi, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë mori parasysh edhe me provat e tjera në shkresat e lëndës,respektivishtë Ekspertizës financiare e datës, 22.02.2021, të cilës ekspertizë gjykata ja fali besimin, me rastin e vendosjes. gjithashtu edhe provave tjera të lartcekura gjykata ua fali besimin e plotë, ngase gjeti se të njëjtat janë të besueshme dhe përputhen në tërësi me gjendjen faktike të vërtetuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe prapsimet procedurale dhe prapsimet materiale të dhëna nga i autorizuari i të padituës, mirëpo të njëjtat ishin pa ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridiko-kontestimore.

Edhe sa i përket propozimit për të pezullimin e procedurës të parashtruar nga përfaqësuesi i të padituës gjykata në një propozim të tillë e ka refuzuar për arsye se për pezullimin e procedurës sepse dispozita e nenit: 68 par.1, të Ligjit nr. 03/L-048 Ligj për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive me të cilin është ndryshuar, riformuluar neni: 67 dhe 68 të Ligjit të njëjtë bazik, në kohen e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka pasur raste të pazgjidhura në gjykata që bazohen në një ankese ose kërkesë të përshkruar me paragrafin 1 të nenit 67 të këtij ligji, dhe Ministria e Drejtësisë nuk është pjesëmarrëse në këtë rast: (I) Rasti, për nga pikëpamja juridike, automatikisht pezullohet , dhe pika (II) Cilido autoritet publik ose gjykate e cila është e përfshirë në rastin e pazgjidhur ose një rast të mëhershëm i cili ndërlidhet me këtë çështje, menjëherë duhet ta njoftoje Ministrinë dhe Ministrinë e Drejtësisë mbi rastin dhe duhet tu siguroje këtyre ministrive një kopje të plote të lendes. Pezullimi vazhdon deri ne skadimin e një afati prej: 180 ditësh i cili fillon në datën kur kopja e lendes gjyqësore i është dorëzuar të dy Ministrive. Një procedure gjyqësore konsiderohet " e pazgjidhur" nëse nuk ka rezultuar në nxjerrjen e një vendimi të prere (kundër te cilit nuk mund te ushtrohet ankesa), në këtë rast fjala është për lendet apo rastet e pazgjidhura që gjenden në gjykate në kohen kur ky ligj ka hyre në fuqi, e që është e datës: 15.07.2010, ***dhe në asnjë rast nuk është për çështjet që janë paraqitur pas kësaj date, ndërsa ne rastin konkret padia është dorëzuar në gjykate me dt. 02.05.2018.***

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve "Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre", ndërsa në dispozitat e nenit 245 parg.1 të LDM-së, ka paraparë se "Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë", andaj meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se e paditura e ka obligim që t'ia kompenson 3 (tri) paga jubilare dhe 3 (tri) paga për përcjellje në pension ashtu siç është përcaktuar me lartë.

Gjykata vendimin lidhur me kamatën e gjykuar e mbështet në dispozitat e nenit: 382 të LMD-se, ku gjykata ka pranuar si moment të fillimit të llogaritjes se kamatës ditën e parashtrimit të padisë në gjykatë me datën, 02.05.2018, ku shuma e gjykuar është nxjerr me ekspertizë financiare , duke i'a njohur paditësit kamatën vjetore prej: 8%, në tërësi ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 382 të LMD-se.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit: 449, 452.1 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësit t'ia paguajë shumën totale prej: 569.00 €, në emër të shpenzimeve të procedurës dhe atë për përpilimin e padis shumën prej: 104 euro, për një seancë gjyqësore shumën prej 135 euro, për një seancë të shtyre shumën prej 75.00 euro, për një seancë shumën prej, 135, dhe 20 euro për taksën gjyqësore për padi, për një seancë të shtyrë shumën prej 75.00 euro, sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, si dhe shumën prej 100 euro në emër të shpenzimeve për ekspertizën financiare, e ne totalë shumën prej, 569.00 euro.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NE ISTOG,
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr. 141/18 me dt.18.05.2021.

Gjyqtari
Migjen Kastrati

Udhëzim juridik :
Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 dite,
nga dita e marrjes Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpër mes të kësaj gjykate.